



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.22, datë 17.03.2020

“PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.157, DATË 26.12.2019, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2020 (I NDRYSHUAR)”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2014 “Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”; nenit 43 dhe nenit 44 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pikës 17 të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”; udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.202 datë 05.03.2020, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.212 datë 11.03.2020, Vendimit nr.157 datë 26.12.2019 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr.157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në nënpikën 1 të pikës 1, miratohet një shtesë fondesh në shumën 2,989,465,525 lekë sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë, të përbërë nga:
 - a. Fondet e trashëguara nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 2019, në shumën 2,335,423,788 lekë.
 - b. Fondet e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme për vitin 2019, në shumën 654,041,737 lekë.
2. Në zbatim të pikës nr.1,a,b, të miratojë detajimin e fondeve të trashëguara nga viti 2019 sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës dhe rishpërndarjen sipas programeve të fondeve për vitin 2020 sipas pasqyrave nr.1, nr.1.1 dhe nr.1.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Në nënpikën 2 të pikës 2 bëhen këto ndryshime:

- 3.1 Miratohet një shtesë në numrin total të punonjësve të Bashkisë Tiranë sipas pasqyrës nr.2 si dhe lidhjet e pagave nr.2, nr.3, nr.4, nr.21, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë detajimin e fondeve të mbartura nga donatorët për vitin 2019, detajimin e fondeve nga donatorët dhe të ardhura të tjera jashtë limitit gjatë vitit 2020 si dhe njoftimin e Këshillit Bashkiak për fondet e akorduara referuar marrëveshjeve të lidhura midis Bashkisë së Tiranës dhe donatorëve, sipas pasqyrës nr.3,3.1 dhe 3.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të miratojë detajimin dhe shtesën e fondeve që i janë akorduar Bashkisë Tiranë nga Qeverisja Qendrore sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Të miratojë rishpërndarjen dhe detajimin e shtesës së fondeve të rindërtimit akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rindërtimit të banesave individuale si dhe ndërtimit të objekteve arsimore në programet e strehimit lokal dhe urbanistikës, të arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor, të arsimit të mesëm të përgjithshëm, të programit të zhvillimit, të kujdesit social për familjet dhe fëmijët si dhe të planifikim, menaxhim administrimit sipas pasqyrës nr.4/1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Të miratojë ndryshimin e emërtimeve të objekteve sipas pasqyrës nr.5 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Të miratojë detajimin e fondit të shpenzimeve dhe investimeve në programin e Shërbimeve Publike Vendore, në programin e Zhvillimit të Turizmit dhe në programin e Kujdesit social për familjet dhe fëmijët sipas pasqyrës nr.6 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Nja dhe Emergjencave Civile, Drejtoria Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave dhe Institucionet në varësi të Bashkisë së Tiranës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

10.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas confirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

